

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më 29/06/2028 ortaku i shoqërisë “ALBADENT GROUP” sh.p.k. me NIPT L62217032L dhe me adresë Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr. 31, Kthesa e Kamzës Tiranë **Znj. Mirmisa Çausholli** lindur në Peqin më 04.04.1947 me Nr. personal E754040580 dhe **Znj. Arjola Çausholli**, lindur në Kamëz me 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G

Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

Dhuruesi: Znj. Mirmisa Çausholli lindur në Peqin më 04.04.1947 me Nr. personal E754040580

Pranuesi: Znj. Arjola Çausholli, lindur në Kamëz me 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G

Neni 1

Objekti kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i pjesëmarrjes në përqindje 100% të **Znj. Mirmisa Çausholli** që zotëron tek shoqëria “ALBADENT GROUP” sh.p.k. për tek **Znj. Arjola Çausholli**.

Neni 2

Vlera e dhurimit

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që **Znj. Mirmisa Çausholli** ka tek shoqëria “ALBADENT GROUP” sh.p.k. është ajo e deklaruar në ekstrakt. Këto kuota do i dhurohen **Znj. Arjola Çausholli**. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.

Neni 3

Kalimi i pronësisë

Hyrja në fuqi e kontratës do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.


Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e dhuruesit

Dhuruesi merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqësor
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.

Pranuesi është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.



Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e pranuesit

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhë konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit së kuotave.

Neni 6
Interpretimi i kontratës në tërësi


Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

Neni 7
Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

DHURUESI

Mirmisa Çausholli



PRANUESI

Arjola Çausholli

